



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranverorë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 02
Prishtinë, më 30 janar 2012, në orën 10:00 salla N-225
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Adem Grabovci

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatore, KIPRED (staf mbështetës) – Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 25.01.2012,
3. Shqyrtimi i rregullave të brendshme të procedurës të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike,
4. Të Ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 25 janar 2012,

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 25 janar 2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i rregullave të brendshme të procedurës të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike,

Kryetari – Tha se Komisioni në punëtorinë e organizuar në muajin nëntor, ka shqyrtuar draft rregullat e brendshme të procedurës së Komisionit. Ftoi kryesuesin e grupit punues që të prezantojë këto draft rregulla.

Armend Zemaj, kryesues i grupit punues - Tha se ky material për nga përmbajtja dhe për nga struktura i plotëson kushtet për miratim. Falënderoj stafin mbështetës të Kuvendit dhe KIPRED-in për kontributin e tyre gjatë hartimit të këtyre rregullave. Këto rregulla janë në harmoni me rregulloren aktuale të Kuvendit, por edhe në harmoni me Udhëzimet e nxjerra më herët.

Në përputhje me fushëveprimtarinë dhe kompetencat Komisioni ka arrit ta kanalizoj punën, detyrat dhe rezultatet. Me këto rregulla të procedurës do të lehtësohet puna në aspektin procedural dhe të vendimmarrjes së Komisionit. Ftoj anëtarët e Komisionit t'i votojnë këto rregulla e të cilat mund të pësojnë ndryshime, varësisht nga natyra e punës së këtij Komisioni.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Vendim

- 1. Miratohen rregullat e brendshme të procedurës për Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.**
- 2. Rregullat e brendshme të procedurës hyjnë në fuqi ditën e miratimit nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike.**

4. Të ndryshme

a) Plani i Punës së Komisionit për vitin 2012

Kryetari – Njoftoi anëtarët e Komisionit se, nga takimi i kryetarit të Kuvendit me kryetarët e komisioneve, ka dalë përfundimi se Plani i punës së Komisioneve duhet të hartohet deri më 31 janar 2012. Plani i punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, hartohet në pajtim me strategjinë legislative të Qeverisë dhe me planin e ZAP-it. ZAP ka dorëzuar në formë elektronike Planin e punës në përfundim të ditës së premte. Përkundër kohës së shkurtër, stafi mbështetës ka përgatitur draft planin e punës, por megjithatë në mënyrë që anëtarët e Komisionit të kenë kohë për shqyrtim të materialit, propozoi që plani i punës të miratohet në mbledhjen e radhës të Komisionit.

Ramiz Lladrovci – Propozoi që Komisioni të dalë me një vërejtje për ZAP-in, i cili nuk ka proceduar me kohë planin e punës dhe si rezultat i kësaj Komisioni është në vonesë lidhur me këtë çështje.

Armend Zemaj – Komisioni mund të miratojë planin e punës ditën e mërkurë dhe të startoj menjëherë me agjendën e tij punuese. Komisioni mund të fillojë me punët - çështjet e mbetura dhe me disa përgjegjësi sekondare që ka.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

1. *Plani i Punës i Komisionit, për vitin 2012, miratohet në mbledhjen e radhës të Komisionit.*
2. *Mbledhja e radhës mbahet ditën e mërkurë, datë 01 shkurt 2012, ora 10:00.*

b). Pjesëmarrja e një anëtari të Komisionit në grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për themelimin e ZAP-it, organizuar nga KDI

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

Armend Zemaj autorizohet që në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike të marrë pjesë në grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Themelimin e ZAP-it dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës, organizuar nga KDI.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu